



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritit dhe Projekteve

**FTESË PËR PJESËMARRJE NË EKSPOZITËN NDËRKOMBËTARE
TË ARTEVE TË BUKURA PËR FËMIJË, LIDICE, ÇEKI, VITI 2017**

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Çeke në bashkëpunim me Komisionin Çek të UNESCO-s, shpall projektin për pjesëmarrje në Ekspozitën Ndërkombëtare të 45-të të Arteve të Bukura për fëmijë (ICEFA), i cili do të mbahet si çdo vit, në Lidice (një qytet i cili u shkatërrua në vitin 1942 nga ushtarët nazistë gjermanë).

Organizatorët e këtij aktiviteti me rëndësi të veçantë i kanë drejtuar ftesë për pjesëmarrje në këtë ekspozitë edhe shkollave shqiptare. Ekspozita e madhe në Lidice ka një traditë të gjatë dhe u drejtohet fëmijëve të moshës 4-16 vjeç. Në vitin 2016, 44 fëmijë nga Shqipëria morrën pjesë në këtë aktivitet dhe tre prej tyre u nderuan me çmim.

Një informacion më i detajuar lidhur me tematikën, teknikat dhe kriteret e artit që do të përdorin fëmijët në punimet e tyre, si dhe kushtet e aplikimit gjenden në faqen: <http://www.mdvv-lidice.cz/en/invitation/>.

Tematika e seksionit të 45-të të Ekspozitës ICEFA Lidice 2017 është “Udhëtimi”.

45th International Children’s Exhibition of Fine Arts Lidice 2017
The Lidice Memorial, Lidice Gallery
Tokajická 152273 54 Lidice
Czech Republic